



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ / ____ /2018

URDHËR

Nr. 4950, Datë 02/052018

PËR

PËRCAKTIMIN E FORMËS SË REGJISTRIT TË POSAÇËM TË MASËS
ALTERNATIVE TË SHMANGIES NGA NDJEKJA PENALE, “PARALAJMËRIM
ME GOJË”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës, të nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 37/2017, datë 30.03.2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur” dhe të nenit 7, pika 2 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Forma e regjistrit të posaçëm të masës alternative të shmangies nga ndjekja penale ndaj të miturit në konflikt me ligjin “Paralajmërimi me gojë” (këtu e në vijim “Regjistri”) është sipas Aneksit bashkëlidhur këtij urdhri dhe që është përbërës i tij.
2. Çdo fletë e regjistrit është e ndarë në 11 (njëmbëdhjetë) kolona, me emërtimet e mëposhtme:
 - i. numri rendor;
 - ii. numri dhe data e kallzimit/procedimit penal (sipas rastit);
 - iii. vendi i dhënies së paralajmërimit me gojë;
 - iv. gjeneralitetet e prokurorit/gjyqtarit që jep masën (emër, mbiemër);
 - v. gjeneralitetet e të miturit: emri, atësia, mbiemri, datëlindja, të dhënat e mjetit të identifikimit (nr. i çertifikatës apo i ndonjë dokumenti tjetër);
 - vi. të dhënat e kujdestarit / përfaqësuesit ligjor / procedural / mbrojtësit / psikologut / përkthyesit / interpretit: emri, atësia, mbiemri, numri personal i identitetit dhe roli në proces;
 - vii. vepra penale e kryer, cilësimi i nenit dhe masa e dënimit të parashikuar në Kodin Penal;
 - viii. rrethanat individuale në lidhje me të miturin sipas nenit 22 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur;

- ix. shpjegimet e dhëna mbi dëmin e shkakuar dhe pasoja që rrjedhin nëse vepra penale përsëritet;
 - x. shënime ku pasqyrohen të dhëna specifike të ndonjë rrethane që lidhet me të miturin referuar raportit individual sipas nenit 47 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur;
 - xi. nënshkrimi i prokurorit/gjyqtarit që ka dhënë masën alternative të shmangies dhe i personit që administron regjistrin.
3. Në rast se bëhen gabime materiale në hedhjen e informacionit në regjistër, fjala e shkruar gabim nuk fshihet, por i vihet një vizë në mes në të gjithë gjatësinë e saj, futet në kllapa, duke vijuar të shkruhet informacioni i saktë dhe personi që bën korrigjimin bën shënimin “e korrigjuar” dhe nënshkruan në kolonën “Nënshkrimi”.
4. Përdorimi dhe aksesimi i të dhënave të të miturit që mbahen në regjistër kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
5. Për ruajtjen, përpunimin dhe administrimin e regjistrit zbatohen rregullat dhe procedurat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për arkivat.
6. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë për njoftimin e këtij urdhri Prokurorisë së Përgjithshme dhe gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI


Etilda Gjona (Saliu)



